

Vendi: Volljak, Klinë

Data: 30.11.2024

## PROCESVERBAL

### Zgjedhjet e Këshillit Lokal në Volljak

*Fillimi takimit në bashkësin lokale: ora 17:10*

*Përfundimi i takimit: 17.35.*

Në sallën e takimit (Shkolle fillore) ishin prezent 5 antarët e komisionit, Takimi është hapur me një fjalë hyrese nga Kryetari I komisionit z. Binak Sylaj, I cili filloi me prezantimin e qëllimit për zgjedhjet e Këshillit lokal, duke përmendur dhe theksuar se do të jetë një kryesi me antarë të saj që do të përfaqsojnë nevojat komunitetit fshatrave si: Volljak, Qupevë dhe Dush.

Pas këtij prezantimi detajor sipas udhëzimit administrativ nga kryetari I komisionit, të gjithë qytetarët e tri (3) fshatrave ishin dakord që votimi të jetë i hapur/votim me Aklamacion.

Gjithashtu propozuan për përfaqësues të të gjitha fshatrave për të l'u bashkuar komisionit z. Sali Berisha, si dhe masa prezente vendosi me vota të hapura që kryesia e këshillit lokal Volljak të përbehet nga 9 antarë.

Fshataret filluan me propozimet e tyre për kryetar të këshillit Lokal Volljak, dhe kishin vetëm një propozim dhe ai ishte z. Shani Berisha, Kryetari komisionit pyeti se mos kishin ndonjë propozim tjetër por askush nuk propozoi ndonjë kandidat tjetër.

#### **Propozimi për kryetar:**

Duke u bazuar në rezultatit e zgjedhjeve pasë numrimit të votave, kemi të zgjedhur Kryetarin e Këshillit dhe kryesin:

1. Shani Berisha, Kryetar – (1 votuar me shumicë votash)
2. Ramë Berisha, Nenkryetar
3. Ejup Berisha, Sekretar
4. Shefqet Berisha, Anëtar
5. Florim Berisha, Anëtar
6. Pajtim Berisha, Anëtar
7. Sajmir Gashi, Anëtar
8. Rexhë Berisha, Anëtar
9. Isuf Berisha, Anëtar

Pas zgjedhjes së kryetarit, masa propozoi që emrat e antarëve të kryesisë të dorzohen me vonë pasi që dëshirojnë të jetë një gjithpërfshirje nga të gjitha fshtrat.

**Pas procesit të zgjedhjes së kryetarit të Këshillit Lokal në Vuçjakë përfundoi në ora 17:35, dhe gjithsejtë kemi 47 votues/Nënshkrime të kësaj zone.**



**Komisioni prezent:**

Kryetar i komisionit: Binak Sylaj \_\_\_\_\_  
Asambleste PDK: Arta Pantina \_\_\_\_\_  
Asmblist AAK: Luigj Ademi \_\_\_\_\_  
Asmblist LVV: Zafer Gashi \_\_\_\_\_  
OJQ: Vitore Zefi \_\_\_\_\_  
Përfaqësuesi I fshatrave: Sali Berisha \_\_\_\_\_

Proces mbajtës: Vitore Zefi